

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	El Niño dhe ngrohja globale/ Më shumë nxehtësi, më shumë lagështi, avujt e ujit arrijnë nivel rekord në atmosferë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/18/el-nino-dhe-ngrohja-globale-me-shume-nxehtesi-me-shume-lageshti-avujt-e-ujit-arrijne-nivel-rekord-ne-atmosfere/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 05:18:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	18 shtator 2026, 05:13:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 18 shtator 2026, 05:12:00 UTC → 18 shtator 2026, 05:14:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aea07233f661f9b30d74d4abd934fff593c17024c44449087667f72a45ed7d2f
TEKSTI	81038c628c2c00ae5e857691d040333e792bb0b23607a37417ea3d1ec245f6fd
PAMJA	10c75da491e1ed21ad04e5f4184df9bbe5f0851637de7a9dedbacc4729170509

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	43abbf145127c4853f8457ac4dfe05e069dad7da56a189d17542d7567410529a
E MËPARSHMJA	2245fb0c72f51f806df749c94bee6d39037c2f1f3b3a2440601540b5796ee715
RRËNJA MERKLE	35ab8d40f1b8a4415a5ce6150a0f35dfc65972e0cbe708d5f8ac326bd7570577
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te bllok, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/43abbf145127c4853f8457ac4dfe05e069dad7da56a189d17542d7567410529a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA KRYESORE TË FUNDIT

El Niño dhe ngrohja globale/ Më shumë nxehtësi, më shumë lagështi, avujt e ujit arrijnë nivel rekord në atmosferë

18/09/2026 07:13



Atmosfera e Tokës përmbajti në gusht sasinë më të lartë të avujve të ujit të regjistruar ndonjëherë, duke rritur rrezikun për valë të forta të të nxehtë dhe reshje ekstreme në pjesë të ndryshme të botës.

Të dhënat e reja vijnë nga Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike i programit evropian Copernicus (C3S). Shkencëtarët thonë se ngrohja globale ka ndikuar në këtë rekord, pasi një atmosferë më e ngrohtë është në gjendje të mbajë më shumë lagështi. Në të njëjtën kohë, fenomeni El Niño në Oqeanin Paqësor mendohet se ka kontribuar në rritjen e sasisë së avujve të ujit.

Rekord i ri për avujt e ujit

Sipas të dhënave të C3S, gjatë muajit gusht sasia e avujve të ujit në atmosferë arriti në 27.35 kilogramë për metër katror.

Kjo vlerë tejkaloi rekordin e mëparshëm, të regjistruar në korrik të vitit 2024, me 0.04 kilogramë për metër katror.

Shifra tregon sasinë e avujve të ujit që ndodhen në një kolonë ajri mbi një metër katror të sipërfaqes së Tokës, duke u shtrirë përgjatë gjithë atmosferës.

Sipas një përlllogaritjeje të shkencëtarëve, rritja prej 0.04 kg/m² në krahasim me rekordin e mëparshëm është e barasvlershme me rreth 20 trilionë litra ujë shtesë në atmosferë.

Atmosfera më e ngrohtë mban më shumë lagështi

Julien Nicolas, shkencëtar i lartë në C3S, tha se rekordi për avujt e ujit është në përputhje me temperaturat jashtëzakonisht të larta globale të regjistruara gjatë gushtit.

Sipas tij, ajri mund të mbajë rreth 7% më shumë avuj uji për çdo një gradë Celsius ngrohje globale.

Oqeanet tropikale janë ndër burimet kryesore të avujve të ujit në atmosferë. Temperaturat jashtëzakonisht të larta të sipërfaqes së detit në këto rajone gjatë gushtit, pjesërisht të lidhura me forcimin e kushteve të El Niño-s, kanë rritur avullimin dhe mendohet se kanë ndikuar në rekordin e ri.

Më shumë avuj uji, më shumë rrezik për reshje ekstreme

Rritja e sasisë së avujve të ujit në atmosferë mund të ndikojë në intensitetin e reshjeve, përfshirë ato të lidhura me ciklonet dhe stuhi të fuqishme.

Kur avujt e ujit kondensohen dhe shndërrohen në nika uji brenda reave, çlirohet nxehtësi

I Kryesore



"Kushtetuesja s'mund të bëjë lojën"/ Miratohet formula për pagat e magistratëve, Rama në Kuvend: Është nevoja për të hartuar një ligj të ri

07:19

Debat Rama-Tabaku në Kuvend, deputetja e PD: Dorëhiq, zbato kërkesën e qytetarëve. Kryeministri: Opozita që përziehet nga protesta quhet 'amanet mushkat, se kuajt ikën'

08:24

Lojëra fati dhe kanabis në një lokal, arrestohet 47-vjeçari në Malësinë e Madhe

08:54

Basketbolli në zi, ndahet nga jeta në moshën 43-vjeçare ish-ylli i NBA

10:54

I Më të lexuarat

Kryeministri Rama viziton Malin Athos në Greqi, qëndron gjatë natës në Manastirin e Vatopedisë

Pas vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së, Richard Grenell publikon foton e Bleona Qeretit me bluzën kuqezi

Dënimi me 81 vite i ish-liderëve të UÇK-së, Grenell në Top Story: Kosova s'ka nevojë që vendimet t'i marrë një gjykatë në Holandë, duhet të vendosë vetë

"Vendimi nga Haga është pozitiv për Kosovën", deklarata e studiuesit Spahiu shkakton debat në Top Story, Rakiplllari: Je gëzuar ti më shumë se Vuçiç

Deputetja e PDK tregon në Top Story prapaskenat e largimit të spiunëve nga Kosova, Musliu: Në 2015-ën u mbushën autobusët, gënjyen edhe për...

Arrestohet Kastriot Hasko, ortaku i Bedinajt te prona në konflikt me Luan Muçën në Palasë, akuzohet për falsifikimin e 1143 hektarëve në Fier

Hashim Thaçi reagon për herë të parë pas dënimit me 25 vite burg nga Gjykata në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin

'JO NË EMRIN TIM', Taulant Xhaka shpërthen pas Hagës, reagimi i tij tërbon mediat serbe

Miratohet me 84 vota ligji i maxhorancës që rrit me 2% rrogat e magistratëve, Rama debaton me opozitën deri në orët e para të

kur energji e gjatë kohës nën tension dhe energjia në përafërsisht të njëjtë, gjatë kohës. Kjo energji mund të kontribuojë në forcimin e stuhive.

Shkencëtarët paralajmërojnë gjithashtu se lagështia e lartë mund t'i bëjë valët e të nxehtë me të rrezikshme, pasi pengon ftohjen gjatë natës dhe e bën më të vështirë rikuperimin e organizmit pas ditëve me temperatura shumë të larta.

Gushti, ndër muajt më të nxehtë të regjistruar

Gushti ishte gjithashtu ndër muajt më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë, sipas të dhënave të ERA5 të Copernicus, të cilat shkojnë deri në vitin 1940.

Ndërkohë, të dhënat e administratës amerikane NOAA, që kanë një seri matjesh që nis në vitin 1850, e renditën gushtin si muajin më të nxehtë të regjistruar në historinë e kësaj serie.

Shkencëtarët e lidhin këtë prirje me emetimet e gazeve serrë nga djegia e lëndëve djegëse fosile, ndërsa El Niño po ashtu luan një rol në rritjen e temperaturave globale.

Një cikël që mund të përforcojë ngrohjen

Avujt e ujit janë vetë një gaz serrë dhe luajnë rol në sistemin klimatik të Tokës.

Sa më shumë të ngrohet atmosfera, aq më shumë avujt mund të mbajë ajo. Kjo lagështi shtesë kontribuon më tej në efektin serrë dhe mund të përforcojë ngrohjen.

Shkencëtarët theksojnë se, megjithëse rekordi i ri për sasinë e avujve të ujit mund të duket i vogël në terma absolutë, rritja e vazhdueshme e lagështisë atmosferike mund të ketë pasoja të rëndësishme për temperaturat ekstreme, reshjet dhe stuhitë.

Fenomeni aktual El Niño në Paqësorin tropikal pritet të jetë ndër episodet më të forta të regjistruara, ndërsa shkencëtarët paralajmërojnë se ai mund të ndikojë në temperaturat globale edhe gjatë vitit të ardhshëm.

Top Channel

I Bota »



Trump paralajmëron bazë të re amerikane në Poloni: Po bëhet përparim i madh

18/09 10:52



"Nuk më besohet çfarë tha"/ Vëllai i Princeshë Dianës: Mbreti Charles dukej jashtëzakonisht i gëzuar natën e vdekjes së saj

18/09 10:22




Greqia përkujton sot 13-vjetorin e vrasjes së muzikantit dhe aktivistit antifashist Pavlos Fyssas, tubime dhe marshime në disa qytete

18/09 10:04



SHBA-Rusi, ndryshon qasja? Uashingtoni shqyrton bashkëpunimin ekonomik para fundit të luftës

18/09 09:57



Podiume bosh, shpërblime për votimin elektronik dhe opozita jashtë gare/ Rusët votojnë mes përshkallëzimit të luftës në Ukrainë

18/09 09:56



Qeveria në Greqi premtan ulje të çmimit të naftës, Mitsotakis: Mbështetje nga shteti dhe rafineritë

17/09 22:45

I Kryesore »



Reforma në Procedurën Penale, Gogu zbulon ndryshimet: Po punojmë për forcimin e



Sherri i dhunshëm në Sarandë/ Dy vëllezërit plagosen brenda berberhanes, përleshja vijon



Presidenti Begaj dekreton ligjin për formulën e re të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve

mëngjesit

Ekskluzive/ "Kur u njoha me të, ishte në burg", rrëfimi prekës i gruas së Jakup Krasniqit pas dënimit në Hagë: E prisnim në shtëpi, i kam premtuar se...

alternativave ndaj arrestit në burg, në 2027 me mbikëqyrje elektronike

18/09 10:55



Zegjineja debat me Bardhin pas mesnate në Kuvend/ Demokrtati: A t'u martua daja ty? Çaushti: Shiko hallin tënd Gazo

18/09 10:39

edhe jashtë ambienteve, arrestohen 3 të rinj

18/09 10:48



Milani nis reflektimin pas humbjes me Benficën, drejtuesit e klubit marrin vendimin për Ruben Amorim

18/09 10:37

18/09 10:44



SHBA-Rusi, ndryshon qasja? Uashingtoni shqyrton bashkëpunimin ekonomik para fundit të luftës

18/09 09:57

Na ndiqni:



I Video »



Top Channel/ "A t'u martua daja ty?"/ Zegjineja i kthehet Bardhit: Shiko hallin tënd Gazo



Top Channel/ "Protestuesit s'ju duan", Rama-opozitës: Jeni sëmundje ngjitëse, kush rri me ju humb



Top Channel/ "GJK-ja nuk mund t'i thotë kurrë Kuvendit...", Rama: Deputeti është i paurdhërueshëm



Top News- Gjysma e shqiptarë nuk mbyllin dot muajin/ Vështirësi financiare dhe çmime të larta



Top Channel/ "Liria ka emër"/ Pas vendimit të Hagës, ish-luftëtarët e UÇK-së zbarkojnë në Durrës



Top News – Rama pas mesnate në Kuvend. 'Kushtetuesja tejkaloi kompetencat, nuk na urdhëron dot'

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tani!
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.